



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komisioni Komunal për dhënie në shfrytëzim të  
Pronës së paluajtshme Komunale  
Nr. 01/\_\_\_\_  
Dt. 15.05.2015

Në bazë të nenit 5 të Ligjit nr. 04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 7 të Rregullores QRK nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/133 datë/12.05.2015, për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale,

Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, më datë 15.05.2015, shpallë :

**NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK**  
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR 2 ( dy )VITE, TË PRONËS SË PALUAJTSHME**  
**KOMUNALE- PISHINËS PUBLIKE NË FSHATIN BANJË**

**EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

Emri zyrtar dhe Adresa e autoritetit Kontraktues	Komuna e Malishevës Komisioni Komunal për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike-komunale		
Adresa	Rr "Gjergj Kastrioti – Skenderbeu" pn.	Kodi postar Malishevë	24000

**LËNDA E ANKANDIT**

Autoriteti kontraktues – Komuna e Malishevës, në bazë të Vendimit nr.02/133, dt.12.052015, ka përcaktuar si qëllim dhënie shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale “Pishina Publike në fshatin Banjë” personave juridik dhe personave fizik në afat prej 2 ( dy ) vite, përmes ankandit publik, procedura përmes ofertave të mbyllura.

**Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër ( dy vite ) e pronës së paluajtshme komunale, si vijon :**

1. Prona publike e lartcekur ndodhet ne pjesën e ngastrës kadastrale në fshatin Banjë, KK-Malishevës, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5147 m<sup>2</sup>, e cila gjendet në pjesën e ngastrës kadastrale nr.P-7231001-01692-1, në vendin e quajtur Bazhlina te Bazeni, pronë publike në emër të KK-Malishevës.

2. Kriteri i Dhënies së Kontratës : Oferta më e favorshme ekonomike dhe me çmimin më të lartë,
3. Çmimi fillestarë për një vit është 10,000.00 € ndërsa për dy vite 20,000.00 €.
4. Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës është 2 ( dy ) vite.
5. Veprimtaria që ushtrohet në hapësirat e dhëna në shfrytëzim është kryesisht veprimtari rekreative dhe biznesi brenda hapësirave të përkufizuara sipas udhëzimeve të drejtorisë për shërbime publike..

### **INFORMATATA ADMINISTRATIVE**

1. Afati kohorë i fundit për tërheqjen e dokumentacionit të ankandit : data 13/06/2015 ora 15.00
2. Afati i kohorë i fundit për pranimin e Aplikacioneve: data 14/06/2015 ora 12.00.
3. Vendi i tërheqjes dhe dorëzimit të aplikacioneve te ankandit publik: Komuna Malishevës, Qendra për Shërbime të Qytetarëve –Shkresorja e Komunës.
4. Takimi për hapjen e Aplikacioneve është publik dhe do të bëhet më datë 15.06.2015, ora 14.00,
5. Ofertat hapen publikisht në sallën e Kuvendit Komunal – Malishevë të cekur si në pikën 4.
6. Ofertat duhen dorëzuar të mbyllura në zarf dhe të njëjtat te regjistrohen sipas procedurës se pranimit te shkresave.
7. Informacionet shtesë mundë ti kërkonti përmes zyrtarëve të drejtorisë për shërbime publike.
8. Ofertat e mbyllura ne formë fizike dorëzohen ne shkresoren e komunës së Malishevës.

### **E drejta për ankesë:**

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë te Komisioni për Ankesa pran Komunës së Malishevës, sipas dispozitave të nenit 9 pika 3 të Ligjit Nr. 04/L-144, Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale.

Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim të  
Pronës së paluajtshme Komunale

Malishevë